

CFARE BEJME NE ?

QKCSA-ISH, është struktura në varësi administrative të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e krijuar me datë 16/09/2005, me autonomi në veprimtarinë teknike - profesionale lidhur me proceset dhe metodat e përmirësimit të cilësisë, sigurisë, përpilimit si dhe vlerësimit të standardeve dhe nen-standardeve (kritereve). Është institucioni i vetëm kombëtar, përgjegjës për kryerjen e akreditimit të institucioneve shëndetësore publike dhe private.

Mbështet Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në zbatimin e strategjise së saj afatgjatë lidhur me përmirësimin e cilësisë dhe sigurisë të kujdesit shëndetësor, konform eksperiencës dhe praktikës shkencore me pozitive dhe standarteve ndërkombëtare në fushat e mëposhtme:.

- Përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së sistemit shëndetësor
- Edukimin dhe trajnimin e personelit mjekësor dhe partnerëve të tjerë, në lidhje me cilësinë e kujdesit mjekësor dhe krijimit të një kulture të re për të.
- Formulimin, përhapjen dhe monitorimin e udhëzuesve klinik (protokolleve klinike) të praktikës klinike më të mirë, në ndihmë të personelit mjekësor.
- Akreditimin e institucioneve shëndetësore shqiptare publike dhe private.
- Edukimin terapeutik dhe fuqizimin e rolit të pacientëve si aktorë kryesor e qendror të sistemit shëndetësor.
- Minimizimin e rreziqeve dhe gabimeve në institucionet mjekësore: Ritjen e sigurisë për pacientët dhe personelin mjekësor.
- Vlerësimin dhe përzgjedhjen e teknologjive ekzistuese dhe të reja më të nevojshme dhe më kostefektive të sistemit shëndetësor.
- Krijimin, mbledhjen dhe përdorimin e evidencës shkencore të praktikave mjekësore të faktuara si më të mirat.

- Vendorsjen e lidhjeve dhe koordinimin teknik të programeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në fushat e mësipërme, me partnerët, institucionet, apo organizata të vendit dhe të huaja të interesuara e të nevojshme për to.

Në procesin e akreditimit, zbaton politikat dhe strategjitë e përmirësimit të cilësisë dhe sigurisë të sistemit shëndetësor, të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.